



**Ministria e Arsimit e Shkencës dhe Teknologjisë
Ministri of Education, Science and Technology
Ministarstvo za Obrazovanje, Nauku i Tehnologiju**

Udhëzim administrativ

Lënda: Plani dhe programi për klasën e parë
NUMER: MASHT 53/01B/2003
DATE: 15. gusht, 2003

Në bazë të nenit 6.1 paragrafi(b),si dhe nenit 7.1 të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesë dhe në përputhje me Rregulloren nr. 2001/19 te datës 13 shtator 2001, mbi Degën e Ekzekutivit te Institucioneve te Perkohshme te Vetëqeverisjes në Kosovë , Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë nxjerr këtë Udhëzim Administrativ.

Neni 1 Qëllimi

1.1 Qëllimi i këtij udhëzimi është zbatimi i Planit dhe programit mësimor për klasën e parë, si rezultat i ristrukturimit të sistemit të arsimit fillor.

Neni 2

2.1 Plani dhe programi i ri per klasën e parë i është bashkangjitur këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 3

3.1 Ky Plan dhe program për klasën e parë zbatohet nga viti shkollor 2003/2004.

3.2 Me zbatimin e Planit dhe të programit të klasës së parë shfuqizohen planet dhe programet e deritashme të klasës së parë të shkollës fillore.

Neni 4

4.1 Ky udhëzim hynë në fuqi më 15 gusht 2003

Mr. Rexhep Osmani, Ministër